



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.05.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen: Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimeve nr. 437 datë 16.5.2019 dhe nr. 607 datë 21.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në qarkun Vlorë për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, si dhe “Për dhënien e mandatit të deputetit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Gjirokastrë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, dhe verifikimi i mandatit të deputetëve respektivisht: z. Ervis Meço dhe znj. Artemis Dralo (Malo).

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Musa Ulqini, Myslym Murrizi, Alban Zeneli, Nimet Musaj, Klotilda Bushka,

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Ulsi Manja

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet për dhënien e mandatit të deputetëve të kandidatëve të listës shumëemërore të Partisë Demokratike në qarkun Vlorë dhe të Partisë Socialiste në qarkun Gjirokastrë.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve. Kandidatët që kanë fituar mandatin e deputetit janë konkretisht:

- Z. Ervis Meço, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 437, datë 16.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Vlorë.

- Znj. Artemis Dralo (Malo), shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 607, datë 21.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Socialiste, Qarku Gjirokastrë.

Janë njoftuar kandidatët respektivë që të jenë të pranishëm në këtë mbledhje Këshilli. Arsyeja e thirrjes është pasi na është krijuar një precedent dhe sipas Rregullore së Kuvendit të shpreheni nëse e pranoni të bëni betimin në seancën e sotme në zbatim të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?

Gramoz Ruçi – Zoti Ervis pranoni ta bëni betimin në seancë?

Ervis Meço – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Zonja Artemis pranoni ta bëni betimin në seancë?

Artemis Dralo (Malo) – Po, pranoj.

Gramoz Ruçi – Kjo është një procedurë e zakonshme për të mos ndodhur ndonjë precedent, është një kërkesë e Rregullores para se të kalojmë në seancën plenare që ju do të bëni betimin, prandaj jeni të ftuar që të uleni sot në sallën e Kuvendit që fillon në orën 10:00, pasi pika e parë e rendit të ditës do të jetë betimi që ju do të bëni në Kuvend që të filloni ushtrimin e mandatit të deputetit. Faleminderit dhe suksese paraprakisht!

(largohen kandidatët për deputetë...vijon mbledhja me anëtarët e Këshillit)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet e mësipërme, nr. 437 dhe nr. 607 i ka dhënë mandatin e deputetit kandidatëve vijues të listave respektive. Vendimet i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetëve të ri?

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Znj. Klotilda Bushka ta lexojë në seancë raportin e përmbledhur, siç është rregulli, i cili shpreh këtë qëndrim të Këshillit, që i paraqitet Kuvendit në seancë.

Mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET